

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E ENJTE 17 MARS 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot diskutojmë raportin vjetor të Këshillit të Integritit European në një moment shumë të vështirë që po kalon Europa për shkak të agresionit rus në Ukrainë dhe prioriteteve që sot ka agjenda europiane në solidaritet me Ukrainën. Në këtë luftë dhe në këto kohë luftërash dhe krizash ekonomike, qeveritë e përgjegjshme të rajonit, por jo vetëm, kanë dalë përpara qytetarëve duke u folur hapur, duke hartuar paketa dhe masa konkrete, për t'u ardhur në ndihmë shtresave në nevojë dhe qytetarëve, mbi të cilët rëndon rritja e çmimit të karburantit, si pasojë edhe ajo e produkteve bazë, gjë që e kanë bërë të papërballueshme koston e jetesës. Kjo është arsyeja përse në rajon nuk ka pasur protesta. Por çfarë ndodhi në vendin tonë? Kur qytetarët u përballën me rritjen e çmimit të karburantit, që shkoi 290 lekë litri, kur çmimi i bukës u rrit me 20 lekë menjëherë dhe çmimi i vajit, i miellit dhe i produkteve të shportës u rrit me 20%, duke bërë që qytetarët të mendohen 2 herë përpara se të shkojnë në dyqanet ushqimore, sikur të mos mjaftonte kjo, ata u përballën me një qeveri, që u dorëzua duke thënë: "Qeveria nuk ka punë me çmimet", "Ecni në këmbë se kurseni", pra me një arrogancë, që shkon deri në tallje, përballë varfërisë dhe shqetësimit me të drejtë të tyre.

Prandaj sovrani mbushi sheshet, duke treguar edhe një herë forcën e numrave dhe jo të dhunës; forcën e argumentit dhe të drejtën për të ngritur zërin kundër keqqeverisjes, me të cilën përballen çdo ditë, që ua ka bërë të vështirë jetën e tyre normale në një vend që ka detyruar të largohen mbi 500 mijë të rinj. Mijëra qytetarë në rrugët dhe sheshet e Shqipërisë zgjodhën të qëndrojnë përballë këtij regjimi, duke ushtruar të drejtën e tyre të protestës, për të kërkuar llogari dhe për të treguar se kush vendos në këtë vend. Vetëm pasi qytetarët u derdhën në sheshet e Shqipërisë, qeveria u kujtua se ka kompetencë për të ndërhyrë në tregun e hidrokarbureve, për të ngritur një bord apo për të hartuar një paketë ndihme, e cila është e pamjaftueshme për pensionistët, studentët dhe familjet e varfra shqiptare për të përballuar jetesën. Po i jap qeverisë disa shifra, që ndoshta ende nuk i di. Ukrainasit në luftë po e blejnë naftën me 1 euro për litër, ndërsa shqiptarët në paqe me 2,2 euro litrin; Mali i Zi e blen me 180 lekë litrin, Bosnja e blen me 172 lekë litri dhe Maqedonia e blen me 145 lekë litrin.

Në Shqipëri një qytetari me të ardhura mesatare 26% e pagës i duhet për karburant dhe 40% e të ardhurave i shpenzon vetëm për ushqime. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar rreth 40% e popullsisë jeton me më pak se 5,5 dollarë në ditë, pra me një pagë minimale 238 euro në muaj, dhe e paguan çmimin për 1 litër karburant më shtrenjtë se vendet e Bashkimit European. Sot 60% e taksave, që rëndojnë çmimin e naftës, janë të vendosura nga qeveria "Rama". Prandaj Lëvizja Socialiste për Integritim ka sjellë në parlament një iniciativë ligjore, një masë konkrete për uljen e çmimit të karburantit, duke plotësuar një prej kërkesave të qytetarëve, heqjen e dy taksave: taksën e qarkullimit dhe taksën e karbonit nga nafta dhe benzina. Kjo ndërhyrje do t'u vijë në ndihmë buxhetore familjeve e bizneseve

dhe nuk e rëndon aspak buxhetit të shtetit të vitit 2022. Që ta dinë të gjithë shqiptarët, qeveria po pasurohet në kohë krize nga të ardhurat e realizuara nga TVSH-ja, që janë rritur, ku për muajt janar – shkurt janë 18 milionë lekë, sipas deklarimeve zyrtare të Ministrisë së Financave, dhe do të vazhdojnë të rriten ndjeshëm si pasojë e rritjes së çmimeve. Kjo nismë që duhet të miratohet sot, menjëherë, do të ndihmojë konsumin familjar dhe qëndrueshmërinë e punës së bizneseve. Gjithashtu, ne kemi nevojë më shumë se kurrë për të rritur prodhimin vendas, për ta mbrojtur atë, ashtu siç po bëjnë të gjitha qeveritë e përgjegjshme të Bashkimit European.

Sot nafta jonë bruto, është vërtet e rëndë dhe ka përqindje shumë të lartë plumbi, pastrohet në rafineritë e Italisë. Prandaj ne mendojmë që duhet ndërtuar menjëherë një rafineri naftë, që kushton 100 milionë euro, e cila do të mbulonte mbi 80% të nevojave të vendit dhe do të punësonte mbi 1000 naftëtarë me paga dinjitoze. Kjo do të ulte ndjeshëm kostot e rënduara të shqiptarëve të varfër dhe do të krijonte pavarësi të tregut të brendshëm nga krizat, që mund të godasin sot dhe nesër Shqipërinë. Ky buxhet gjendet shumë lehtë, duke ndalur pagesat për inceneratorin e Tiranës, që nuk ekziston. Shqiptarët, që sot jetojnë me 5,5 dollarë në ditë, qeverisen nga një qeveri që vjedh 430 milionë euro, një mega-afërë korruptive në vendin më të varfër në rajon. Personalisht kam qenë pjesë e protestave qytetare dhe jam e gatshme që propozimet e tyre t'i sjell në parlament dhe të jenë pjesë e këtij institucioni dhe vendimmarrjes së këtij institucioni, i cili duhet të përfaqësojë interesat e shqiptarëve dhe jo interesat e oligarkëve apo të një grushti njerëzish pranë Kryeministrit.

Kjo qeveri në vend që të dëgjonte kërkesat dhe thirrjet e mijëra qytetarëve, i dha urdhër politik Policisë së Shtetit që të dhunonte gratë, vajzat dhe qytetarët, në shkelje të ligjit. Drejtori i Policisë së Tiranës ka guxuar dhe urdhëruar vartësit e tij të dhunojnë qytetarët jashtë kamerave, sepse dhuna duhet ekzekutuar dhe aspak në prani të dëshmitarëve. Policë pa uniformë, pa shenja identifikuese, me armë në brez dhe kapuçë në kokë, si një bandë, dhe aspak në dinjitetin e Policisë së Shtetit, rrahën dhe dhunuan gratë dhe vajzat që protestuan sipas ligjit, pa shkelur një lule, pa dhunuar një institucion dhe pa thyer një xham. Lirinë për të protestuar qytetarëve shqiptarë nuk ua jep as Kryeministri dhe as qeveria juaj; ajo kanë lindur me secilin prej nesh, si një e drejtë themelore e njeriut, ndërsa ju bashkë me institucionet keni vetëm detyrimin që të siguronit zbatimin e kësaj të drejte. Protesta është dinjitet, është shpresë, është forcë e sovranit për të kërkuar llogari; nuk është turp, siç e quajtet ju, zoti Kryeministër. Turp është të vjedhësh 430 milionë euro, me një skemë të një grupi të strukturuar kriminal; turp është të jesh vendi më i korruptuar në Europë; turp është arroganca juaj karshi qytetarëve, që kërkojnë drejtësi dhe një jetë të denjë në vendin e tyre; turp është të largosh 500 mijë të rinj nga vendi. Ky është turp, sepse të protestosh është respekt, mbi të gjitha, për veten tënde. Faleminderit!